

V E N D I M
Nr.89, datë 1.3.1993

PËR DHËNIEN E LICENCEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TURISTIKE

Me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Neni 1

Çdo person fizik a juridik që dëshiron të ushtrojë veprimtari turistike, si agjenci turistike udhëtimi, gidë-përkthyes, veprimtari hoteliere, bar-bufe, restorant, transport udhëtarësh e taksi duhet të pajiset me licencë të lëshuar nga Ministria e Turizmit ose organet e pushtetit lokal në përputhje me rregulloret përkatëse.

Neni 2

Ministria e Turizmit përcakton në rregullore përkatëse kriteret, kushtet dhe procedurat për lëshimin e licenceve për ushtrimin e veprimtarive turistike, normativat për kategorizimin në klasa të ndryshme turistike të këtyre veprimtarive, procedurat për klasifikim, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, masat që merren për shkeljet e vërtetuara, si dhe rastet kur licenca lëshohet nga organet e pushtetit lokal.

Neni 3

Asnjë subjekt nuk lejohet të ushtrojë veprimtari turistike në rast se nuk disponon licencë.

Neni 4

Ministria e Turizmit ngarkohet të nxjerrë rregulloret përkatëse.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi